

334.722 (497.115)

Donjeta Morina, MA¹

**FAKTORËTQË PENGOJNË ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT
NË KOSOVË**

**ФАКТОРИТЕ КОИ ГО СПРЕЧУВААТ РАЗВОЈОТ НА
ПРИВАТНИОТ СЕКТОР ВО КОСОВО**

**FACTORS THAT PREVENT PRIVATE SECTOR DEVELOPMENT
IN KOSOVO**

Abstract

Business is an important tool for economic development and social stability of all countries. The private sector has been always necessary to achieving important development results in all countries of the world. Growth and sustainability of the private sector is definitely necessary, since it is difficult to imagine general raising of standards of living without such development. No matter the great role that businesses have in economic development, economic situation in Kosovo is yet very challenging to building business capacity. There is still no indication that promotes economic growth in satisfied level. Creating a favorable climate for business primarily relates to the macroeconomic situation favorable, creating a legal infrastructure and physical incentives for businesses, and offering them the opportunity to create and opportunities for reducing costs and free development activity and unobstructed.

Our paper aims to identify the types of barriers faced by businesses in the conduct of their business activity, and is based on quantitative data derived through a survey carried out with 300 SMEs. The results shows that businesses in Kosovo are not sufficiently developed, because it still faced a business environment not so friendly. So, it will be noted in the paper, businesses in Kosovo faced significant obstacles, which hamper their growth and development and hinder the process of economic recovery.

¹Accounting and Finance, University “Haxhi Zeka”, email: d.morina@live.com

Abstrakt

Biznesi është mjet i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik dhe stabilitetin social të të gjitha vendeve. Sektori privat ka qenë gjithmonë i domosdoshëm për arritjen e rezultateve të rëndësishme të zhvillimit nëpër të gjitha vendet e botës. Rritja dhe qëndrueshmëria e sektorit privat është padyshim e nevojshme, pasi që është e vështirë të imagjinohet rritja e standardeve të përgjithshme të jetesës pa një zhvillim të tillë. Pa marrë parasysh rolin e madh që kanë bizneset në zhvillimin ekonomik, prapë se prapë gjendja ekonomike në Kosovë është shumë sfiduese për ngritjen e kapaciteteve biznese. Ende nuk ka tregues të cilët e nxisin rritjen ekonomike në nivel të kënaqshëm. Krijimi i një klime të përshtatshme për biznesin lidhet në radhë të parë me situatën e favorshme makroekonomike, krijimin e një infrastrukture ligjore dhe fizike, stimuluese për bizneset, duke ju ofruar atyre mundësi për krijim dhe mundësi për uljen e kostove dhe zhvillimin e aktivitetit të lirë dhe pa pengesa.

Punimi ynë synon të identifikoj llojet e barrierave me të cilat ballafaqohen bizneset në Kosovë gjatë ushtrimit të aktivitetit të tyre biznesor, dhe është i mbështetur në të dhëna kuantitative të realizuara përmes një anketimi të kryer me 300 NVM. Rezultatet na tregojnë se bizneset në Kosovë nuk janë të zhvilluara sa duhet, pasi që vazhdojnë të përballën me një mjedis biznesor jo edhe aq miqësor. Pra siç do të ceket në punim, bizneset në Kosovë përballën me pengesa të mëdha, të cilat pengojnë rritjen dhe zhvillimin e tyre dhe që konsiderohen si faktorët kryesorë që e ngadalësojnë procesin e rimëkëmbjes ekonomike.

1. Hyrje

Kosova është një prej vendeve në tranzicion, ku kalimi në ekonominë e tregut është i lidhur ngushtë me zhvillimin e sektorit privat. Në Kosovë sektori privat përbëhet nga ndërmarrjet mikro, të vogla, të mesme dhe të mëdha. Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) përbëjnë rreth 98% të të gjitha ndërmarrjeve në Kosovë dhe kanë potencial që të luajnë rol të rëndësishëm në rritjen ekonomike. Botërisht është i njohur fakti se zhvillimi i bizneseve e veçanërisht zhvillimi i NVM-ve është i një rëndësie madhore, sidomos për ekonomitë në tranzicion si kjo e Kosovës. Megjithatë në aspektin global është vërtetuar se zhvillimi i bizneseve kushtëzohet nga mjedisi i caktuar biznesor, që mund të ofroj një vend dhe krejt natyrshëm ky mjedis biznesor është i ndryshëm nga një vend tek tjetri. Mjedis i biznesit është një koncept që i referohet kuadrin institucional, mekanizmave rregullatorë, stabilitetin makroekonomik, stabilitetin të çmimeve dhe rritjes së industrisë në përgjithësi. Sidoqoftë këto ndërmarrje vazhdojnë të përballën me barriera të vendosura nga ambienti afarist, përfshirë rregulloret komplekse dhe

joefikase, vështirësitë për qasje në shërbimet financiare, problemet legjislative, etj. Këta faktorë apo barriera e pengojnë rritjen dhe progresin e këtyre ndërmarrjeve dhe gjithashtu kontributin e tyre në zhvillimin ekonomik. Këta faktorë veprojnë si frena në aktivitetet afariste dhe e dëmtojnë imazhin e ambientit afarist të Kosovës. Përderisa disa nga këta faktorë janë trashëguar nga e kaluara, të tjerët faktorë janë si rezultat i paqartësive të vazhdueshme që mbizotërojnë në Kosovë që nga periudha e pas luftës.

Është e rëndësishme për sipërmarrësit të marrin masa adekuatë për zvogëlimin e pasojave që mund të sjellin këto barriera. Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm biznesi dhe mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm të NVM-ve, janë kushtet themelore për zhvillimin ekonomik dhe rritjen e mirëqenies sociale si dhe një burim punësimi, rinovimi dhe produktiviteti. Për këtë arsye sot objektivi kryesor i institucioneve në vendin tonë është të punojnë në drejtim të rritjes dhe mbështetjes së këtij sektori, në mënyrë që ta bëjnë sa më atraktiv për sipërmarrësit e rinj. Një mjedis biznesi më atraktiv, do t'u jepte mundësi sipërmarrësve të rinj të futën në këtë sektor, e në këtë mënyrë të rrisin mundësitë e punësimit në nivel të vendit dhe të zvogëlonin nivelin e varfërisë. Punimit në vazhdim përmes analizës empirike, i mbetet të identifikoj këto lloje të barrierave dhe të shpjegoj rolin e tyre në mbarëvajtjen e punës së bizneseve kosovare. Gjithashtu rëndësi do t'i jepet edhe shtjellimit të mundësive për eliminimin apo zvogëlimin e këtyre barrierave.

2. Rishikimi i literaturës

Duke pasur parasysh peshën e tyre në ekonomi, bizneset konsiderohen si drejtuese të inovacionit dhe punësimit, dhe në këtë mënyrë një bazë potenciale për rritjen ekonomike në përgjithësi. Shumë studime nga autorë të ndryshëm kanë rafinuar këtë pikëpamje duke deklaruar se hyrja e firmave të reja në treg dhe mundësitë që këto firma të operojnë suksesshëm, janë faktorë vendimtar për rritjen ekonomike. Kosova përfaqëson një ekonomi të re, e cila përballët me sfida të mëdha politike dhe sociale. Pavarësisht rolit të madh që kanë bizneset në zhvillimin ekonomik të vendit, ato çdo ditë përballën me një numër të madh të pengesave nga mjedisi i biznesit. Vlerësimet e mjedisit të biznesit në Kosovë, raportojnë një klimë të pafavorshme që pengon rritjen dhe zhvillimin e bizneseve dhe dekurajon investitorët e huaj.

Barrierat e të bërit biznes për NVM-të janë evidente në të gjithë botën. Një studim i ndërmarrë nga Qendra e Kërkimit për Biznesin e

Vogël në Universitetin e Cambridge (CSBRC, 1999), konstatoi se faktorët më të rëndësishëm që pengonin aktivitetin e bizneseve ishin faktorët e jashtëm të biznesit dhe veçanërisht ato në lidhje me çështjet e financave. Ky faktor pasohet nga niveli i kërkesës për produktin apo shërbimin dhe natyrën e konkurrencës në treg. Pronarët e bizneseve të dështuara shpesh vinin theksin mbi mungesën e kapitalit të punës si shkakun e dështimit të biznesit (Braugh, 1970; Hall dhe Young, 1991; Hall, 1992). Pengesa të jashtme për zhvillimin e bizneseve konsiderohen të jenë ato që prekin subjektin sipërmarrës nga jashtë, siç janë; kufizimet e politikës ekonomike, dështimet në legjislacion, në mjedis, tregu i pazhvilluar, etj. (Marian Gal, 2007). Modeli i përgjithshëm për rritjen e shpejtë të bizneseve është se kufizimet kryesore të rritjes janë të lidhura si me faktorët e brendshëm ashtu edhe me ata të jashtëm, që kryesisht kanë të bëjnë me çështjet e financave, punësimin dhe tregjet (Storey, 1994), si dhe me produktet e dobëta dhe marketingun jo-eficient (Hall, 1992; Cramie, 1991; Smallbone, 1991; Watson et al. 1998). Të gjitha studimet mbështesin pikëpamjen se mjedisi i biznesit është një nga faktorët kryesorë që ndikon në rritjen e ndërmarrjeve, e veçanërisht në rritjen e ndërmarrjeve të vogla. Sipas të dhënave nga Banka Botërore (2010), pengesa kryesore në zhvillimin e bizneseve në Kosovë është qasja në kredi bankare. Sipas raportit të BSCK-së, pengesat kryesore për bizneset në Kosovë janë të lidhura me performancën e ulët të faktorëve institucional. Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (2015), numëroi konkurrencën nga ekonomia gri, problemet e furnizimit me energji elektrike dhe praktikat korruptive, si pengesat kryesore për të bërë biznes në Kosovë. Prandaj, sundimi i ligjit nga qeveria shihet si faktor kyç për integrimin e shpejtë në Evropë dhe tërheqjen e investimeve të huaja në Kosovë. Bizneset në vendet e tjera nuk vuajnë aq shumë nga mungesa e ligjeve, konkurrenca e padrejtë, etj., veprime të cilat kryesisht kanë ndikim në veprimtarinë e bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë. Zhvillimi ekonomik, promovimi i punësimit dhe përmirësimi i mirëqenies sociale bazohet në iniciativën private, në konkurrencën dhe tregun e hapur si forca kryesore që sigurojnë prosperitet ekonomik. Qeveria duhet të jetë e angazhuar plotësisht për integrimin e NVM-ve në tregjet rajonale dhe globale. Kosova nuk mund të ketë të ardhme të qëndrueshme, pa një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm.

3. Metodologjia e hulumtimit

Metodologjia e hulumtimit e përdorur në këtë punim konsiston në kombinimin e të dhënave primare dhe sekondare. Mbledhja e të dhënave primare, për të realizuar pjesën empirike të studimit, është arritur përmes një anketimi të kryer me 300 biznese në Kosovë. Pjesa kryesore dhe më e madhe e bizneseve të përfshira në studim, i përkasin sektorit të bizneseve të vogla dhe të mesme, si pjesë shumicë e bizneseve në Kosovë. Anketimi është realizuar përmes pyetësorëve dhe ka përfshirë rreth 70% të qyteteve të Kosovës, si pamundësi për shtrirje më të gjerë. Objektivi i këtij anketimi ka qenë marrja e informacioneve mbi faktorët pengues të veprimtarisë biznese në Kosovë dhe efektet negative të shkaktuara si rezultat i ekzistencës së këtyre faktorëve. Pyetjet e pyetësorit kanë qenë kryesisht të strukturuar dhe me zgjidhje të shumëfishta, dhe u hartuan në atë mënyrë që të ishin të qarta dhe të mos keqinterpretoheshin nga subjektet e anketimit. Renditja e pyetësorit është përpiluar në atë mënyrë që të fillohet me pyetje të përgjithshme mbi veprimtarinë e këtyre ndërmarrjeve, e pastaj të vijohet me pyetje më të ngushta që lidhën direkt me subjektin e temës. Anketimi është bërë me personat përgjegjës të ndërmarrjeve, me pronarët apo menaxherët. Arsyeja e komunikimit vetëm me personat përgjegjës të këtyre ndërmarrjeve ka qenë marrja e informacioneve më të sakta lidhur me aktivitetet e përgjithshme të këtyre ndërmarrjeve. Këto të dhëna të mbledhura përmes këtij anketimi, me pas janë përpunuar dhe janë analizuar përmes programit SPSS.

Ndërsa përmes të dhënave sekondare kemi identifikuar sfondin teorik të temës. Për mbledhjen e këtyre të dhënave, kanë shërbyer literatura të ndryshme dhe raporte mbi gjendjen e bizneseve në Kosovë. Këtu përfshihet edhe studimi i librave dhe artikujve të ndryshëm nga konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare. Të dy këto tipa të të dhënave, si primare ashtu edhe ato sekondare na kanë mundësuar arritjen me sukses të objektivit të punimit dhe kanë mundësuar realizimin me sukses të tij.

Për realizimin e punimit janë shtruar këto pyetje kërkimore, ku pjesa empirike e studimit është kryesisht shtjellim në përpjekje për t'i dhënë përgjigje këtyre pyetjeve:


- Cilat janë barrierat më të rëndësishme që vështirësojnë punën e bizneseve në Kosovë?
- Çfarë efektesh negative sjellin këto barriera në veprimtarinë e bizneseve në Kosovë?

4. Barrierat e të bërit biznes në Kosovë

Kosova përfaqëson një ekonomi shumë të re, e cila përballet me sfida të konsiderueshme politike dhe sociale. Pavarësisht rolit të madh që luajnë bizneset në ekonominë e Kosovës, ato prapë se prapë përballen çdo ditë me një numër të madh të pengesave nga mjedisi biznesor. Për shkak të kushteve të veçanta politike, Kosova ka qenë subjekt i kushteve ekstreme të mjedisit biznesor, që në vazhdimësi kanë ndikuar në zhvillimin e bizneseve të reja. Për shkak të një mjedisi të pafavorshëm për zhvillimin e biznesit dhe mungesës së një kulture kreative sipërmarrëse, Kosovës ende i mungon aftësia për krijimin e ndërmarrjeve inovative, të cilat janë kontribuesit kryesorë në krijimin e vendeve të punës në ekonominë e zhvilluara dhe në ato perëndimore. Në vendin tonë dominojnë bizneset tregtare krahasuar me ato prodhuese dhe shërbyese. Konsiderohet se vetëm 10% e NVM-ve janë ndërmarrje prodhuese. Zhvillimi i biznesit prodhues në përgjithësi, nuk është në përputhje me mundësitë materiale dhe kadrovike që i ka vendi ynë. Ekzistojnë probleme në zhvillimin regjional të biznesit privat. Atë e zhvillojnë kryesisht pronarët në bazë të kapitalit të kursyer nga anëtarët e familjes që përkohësisht punojnë në botën e jashtme. Formimi dhe zhvillimi i bizneseve të reja, kryesisht motivohet për realizimin e fitimit, realizimin e të ardhurave personale të pronarëve, menaxherëve, etj.

Në mesin e shumë barrierave si barriera më të rëndësishme që pengojnë bizneset, e në veçanti NVM-të, që të arrijnë potencialin e tyre të plotë, konsiderohen të jenë: informaliteti në ekonomi, korrupsioni dhe konkurrenca jo korrekte, barrierat financiare, mungesa e ligjeve, mungesa e energjisë elektrike, etj.

Figura 1. Barrierat e të bërit biznes në Kosovë



Burimi: World Bank (2013)

Barrierat financiare janë perceptuar nga bizneset, si barrierat më shqetësuese për zhvillimin e aktivitetit të tyre. Fondet e pamjaftueshme financiare ndikojnë edhe në zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ekzistuese, por edhe në themelimin e ndërmarrjeve të reja. Kufizimet financiare kanë qenë gjithmonë pengesë e madhe për ekonomitë në tranzicion. Edhe në Kosovë, NVM-të janë nën presion nga kufizimet financiare dhe nga tregu i papërsosur. Siç dihet edhe nga hulumtimet, kostoja e lartë e financimit ka dalë të jetë barriera më problematike në listën e barrierave dhe më së shumti për shkak të normave të larta të interesit të aplikuara nga institucionet financiare. Normat e larta të interesit kanë kufizuar bizneset në Kosovë, duke ju kufizuar mundësinë e tyre që të zgjerojnë aktivitetin biznesor dhe të gjenerojnë vende të reja të punës. Duke marrë parasysh faktin se kreditë bankare në Kosovë përbëjnë të vetmin burim financimi për bizneset, atëherë është e dukshme që barrierat financiare të lidhën vetëm më sistemin bankar. Si barriera më të rëndësishme financiare konsiderohen të jenë:

- normat e larta të interesit
- pamundësia për kredi afatgjata
- kolaterali i kërkuar nga bankat
- burokracia e bankave
- informacion jo i plotë financiar mbi kredinë e kërkuar, etj.

Normat e larta të interesit e zvogëlojnë interesimin e bizneseve për kredi, gjë që ndikon në zvogëlimin e investimeve. Investimet e vogla nuk e mundësojnë krijimin e vendeve të reja të punës dhe e pamundësojnë zhvillimin ekonomik. Bankat komerciale në vitet e fundit kanë ulur normat e interesit për kreditë, krahasuar më vitet e mëparshme, mirëpo ende mbetet një diferencë e lartë në mes të normave të interesit në kredi dhe depozita, duke ditur faktin se normat e interesit për depozitat në Kosovë janë shumë të ulëta. Problem tjetër paraqet edhe pamundësia për kredi afatgjata si kufizim për NVM-të. Kur NVM-të arrijnë të sigurojnë financim prej bankave, atyre fillimisht ju ofrohet kredi afatshkurtër. Me qëllim marrjen përsipër dhe realizimin e investimeve produktive, ndërmarrjet kanë nevojë për financim afatgjatë. Kreditë afatgjata janë më të arritshme për ndërmarrjet e mëdha, ndërsa për NVM-të është më e zakonshme të marrin kredi afatshkurtra, si mundësi më e lehtë e sigurimit të kësaj forme financimi. Vështirësi shumë të madhe për marrjen e kredive nga bankat komerciale, paraqet edhe kërkesa e madhe për kolateral. Kosova renditet si shtet me normë të lartë të kolateralit në raport më kredinë e lëshuar. Raporti kolateral-


kredi, respektivisht raporti i mbulimi të kredive me kolateral në Kosovë, për vitin 2012 ishte 236.1% e që është ndër më të lartat në regjion (mesatarja në rajon është 126.6%). Një tjetër pengesë të rëndësishme paraqet edhe mungesa e stabilitetit ekonomik në vend. Mungesa e stabilitetit përbën një pengesë shumë të rëndësishme në mundësitë e NVM-ve për financim, veçanërisht në vendimin e tyre për hua afatgjata. Mungesa e stabilitetit ekonomik shoqërohet me norma të larta të inflacionit dhe ndryshime të mëdha në kurset e këmbimit.

Përmirësimi i qasjes në financa për të gjitha bizneset synohet të arrihet përmes zgjerimit të produkteve financiare, tërheqjes së fondeve nga diaspora dhe përmes ofrimit të trajnimeve mbi qasjen në financa për bizneset. Masat për përmirësimin e qasjes në financa, në mesin e shumë reformave, duhet të përfshijnë edhe reformimin e sistemit kadastral, sistemin e regjistrimit të kolateraleve dhe të kredive dhe zbatueshmërinë e borxhave në raport me kolateralet.

Informaliteti (Korrupsioni dhe konkurrenca jo korrekte). Ekonomia joformale pengon konkurrencën e drejtë dhe rritë kostot relative të bizneseve që operojnë në sektorin formal. Kosova në përgjithësi përballet me informalitet të lartë dhe evazion fiskal, ku një pjesë e madhe e qarkullimit të bizneseve nuk deklarohet në organet tatimore. Kjo gjendje është krijuar për shkak të një periudhe të gjatë të funksionimit ekonomik në mënyrë paralele dhe jo strukturore. Efektet e ekonomisë informale prekin çdo aspekt të rregullimit social dhe ekonomik në Kosovë. Informaliteti dobëson besimin ndërmjet bizneseve dhe institucioneve financiare dhe shkakton dobësimin e marrëdhënieve në mes bizneseve dhe bankave. Në shumicën e rasteve, NVM-të nuk kanë pasqyra financiare dhe kjo rritë vështirësitë e bankës për të konstatuar aftësinë e këtyre ndërmarrjeve për të shlyer kredinë. Përmirësimi i raportimit financiar nga vetë ndërmarrjet, aplikimi i arkave fiskale, do të ndikonte pozitivisht në rritjen e besimit të bankave ndaj këtyre bizneseve duke ndikuar kështu në zvogëlimin e shpenzimeve për monitorimin e raporteve financiare të bizneseve nga bankat. Konkurrenca jo korrekte e shkaktuar nga evazioni fiskal dhe praktikat tjera jo formale, është shumë e dëmshme për zhvillimin e sektorit privat. Kjo krijon ambient që i pengon firmat e reja, legale dhe inovative të rriten dhe të krijojnë vende të reja pune në treg. Për më tepër, dërgon sinjale negative tek investitorët e huaj, duke i dekurajuar ata që të investojnë në Kosovë. Kontratat joformale të punës dhe evazioni sistematik i kontributeve të sigurimeve shoqërore dobëson mbrojtjen e punëtorëve dhe redukton

përfitimet sociale për ta. Kjo ka ndikim negativ në buxhetin e vendit dhe në tërë infrastrukturën e shoqërisë për shkak të të ardhurave në rënie dhe reduktimeve pasuese në ofrimin e shërbimeve të duhura publike.

Figura 2. Përqindja e bizneseve që e konsiderojnë korrupsionin si pengesë për zhvillimin e tyre



Burimi BEEPS (2008)

Mungesa e ligjeve. Ligjet formojnë një shtresë thelbësore të fondacionit për një sektor privat të shëndetshëm. Pa një kuadër transparent dhe një sistem administrativ ligjor, zhvillimi i sektorit privat nuk mund të funksionoj si duhet. Niveli jo i kënaqshëm i zbatimit të ligjit është identifikuar si një nga sfidat kryesore më të cilin përballlet sektori privat në Kosovë. Ligjet nuk janë duke gjetur zbatim të plotë në vendin tonë dhe gjykatat janë ngarkuar me një numër të madh të çështjeve të pazgjidhura. Si bizneset ashtu edhe investitorët e huaj kërkojnë ambient stabil dhe sundimin e ligjit në rastet kur mendojnë të investojnë, përndryshe investime e tyre do të ishin të pasigurta.


Për bizneset në Kosovë, ende mbetet problem furnizimi me energji elektrike, edhe pse vitet e fundit është bërë një përmirësim i dukshëm në këtë drejtim. Përmirësimi i furnizimit me energji elektrike është prioritet për lehtësimin e kushteve për afarizëm dhe ngritjen e prodhimitarisë vendore. Kosova duhet të ndjekë shembullin e shteteve të zhvilluara sa i përket mbështetjes së sektorit privat. Çdo vend i zhvilluar i jep rol shumë të rëndësishëm krijimit të një klime të favorshme biznesore dhe të përshtatshme për zhvillimin e NVM-ve, duke i eliminuar barrierat që i pengojnë ato të rriten dhe të zhvillohen.

Kosova është ende në një fazë kalimtare, ku zhvillimi i sektorit privat pritet të luaj rol kyç në rrugën drejt një ekonomie moderne me treg të lirë dhe rritje ekonomike. Zhvillimi i bizneseve, së bashku me ristrukturimin dhe privatizimin e ekonomisë është vlerësuar prej kohësh si një prej parakushteve kryesore në realizimin e qëllimeve strategjike për zhvillimin ekonomik të vendit. Një ndër shtyllat, në të cilën duhet mbështetur Kosova në rrugën e saj drejt integritimeve rajonale konsiderohet të jetë zhvillimi i sektorit privat më NVM të forta dhe të shëndosha. Formimi dhe zhvillimi i bizneseve të reja do të kontribuojnë në rritjen e punësimit dhe në pajisjen e tregut më produkte dhe shërbime të ndryshme.

5. Analiza empirike e studimit

Bizneset e anketuara në studimin tonë i përkasin aktiviteteve të ndryshme biznesore dhe dallojnë edhe sa i përket madhësisë së biznesit. Bazuar në të dhënat tona të grumbulluara përmes anketimit, tregtia përfaqëson pjesën më të madhe të bizneseve të marra në studim. Tregtia përfshinë 66% të këtyre bizneseve, sektori i shërbimeve përfshinë 26%, ndërsa sektori i prodhimit përfaqëson vetëm 8% të bizneseve të marra në studim.


Figura 3. Struktura e ndërmarrjeve të anketuara sa i përket veprimtarisë biznesore



Burimi: Llogaritjet e autorit

Është vërejtur një koncentrim më i madh i ndërmarrjeve prodhuese në zonat rurale, krahasuar me ato urbane, ndërsa tregtia dhe shërbimet janë më shumë të koncentruara në zonat urbane. Ndërmarrjet shërbyese në shumë vende, duke përfshirë edhe vendin tonë, sot po luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe investimet në këtë sektor nuk kanë munguar. Nga totali i ndërmarrjeve apo bizneseve të marra në studim, pjesa më e madhe e tyre, rreth 73% e ushtrojnë aktivitetin e tyre biznesor në qytet, ndërsa një pjesë rreth 27% në fshatra apo në periferi të qyteteve. Pjesa më e madhe e bizneseve të anketuara i përkasin qyteteve, për faktin se kemi arritur të bëjmë një anketim më të lehtë në qytete krahasuar me fshatrat.


Figura 4. Shtrirja e ndërmarrjeve sipas zonave ku ushtrojnë veprimtarinë



Burimi: Llogaritjet e autorit

Po t'i adresohemi pyetjes lidhur më kohëzgjatjen apo vitet e krijimit për bizneset, shihet se pjesa më e madhe e këtyre bizneseve prej 43% i takojnë atyre më vite të krijimit prej 4 deri në 10. Pastaj një pjesë e madhe prej 34% janë biznese të reja, deri në 3 vjet dhe pjesa tjetër, rreth 23% janë shumë më herët në treg, më kohëzgjatje mbi 10 vite. Këto biznese i kanë rezistuar kushteve afariste jo rrallë të pafavorshme dhe kanë arritur të rritën dhe tani të kenë një pozitë dominuese dhe shumë të rëndësishme në treg.


Figura 5. Shpërndarja e bizneseve të anketuara sipas viteve të krijimit



Burimi: Llogaritjet e autorit

Në rastin e shqyrtimit të barrierave që pengojnë bizneset të arrijnë potencialin e tyre të plotë, kemi parë edhe më herët nga studimet e ndryshme, dhe shohim edhe tani tek anketimi se ka një numër të madh të barrierave afariste të cilat vështirësojnë punën e tyre. Nga të gjithë barrierat, barrierat financiare i prijnë listës së barrierave me 30%. Mungesa e fondeve financiare paraqet problem kronik për ekonominë e Kosovës dhe kufizon zgjerimin e bizneseve të reja. Një pjesë tjetër, prej 25% e konsiderojnë inoformalitetin në ekonomi si barrierën më të rëndësishme në afarizmin e tyre. Nga informaliteti në ekonomi, sipas këtyre bizneseve konkurrenca jo korrekte dhe korrupsioni konsiderohen si pengues të rëndësishëm në ushtrimin dhe zhvillimin e veprimtarisë së tyre.

Figura 6. Barrierat në afarizmin e bizneseve (mostra)




Burimi: Llogaritjet e autorit

Burimet financiare janë shumë të rëndësishme për rritjen dhe zhvillimin e NVM-ve. Këto burime janë një nga burimet kryesore,

vitale dhe shumë të rëndësishme për suksesin e ndërmarrjeve. Një pjesë e madhe e bizneseve nuk kanë qasje në format adekuate dhe të përshtatshme të kredisë dhe kapitalit, dhe në shërbimet financiare në përgjithësi. Zakonisht ndërmarrjet e vogla janë më të kufizuara financiarisht krahasuar me ndërmarrjet e mëdha. Politikat fiskale në Kosovë konsiderohen të favorshme sa i përket normave tatimore, mirëpo megjithatë të gjitha asociacionet biznesore të intervistuar raportojnë se ka problem në implementimin e politikës fiskale. Politikat fiskale janë konsideruar si barrierat kryesore nga 16% e bizneseve të anketuara. Përveç kapaciteteve të kufizuara brenda Administratës tatimore shpesh shkaktohen paqartësi në interpretimin e ligjit dhe vlerësimin e bazës tatimore, si rezultat i së cilës bizneset të cilat paguajnë taksat shpesh përfundojnë duke paguar gjopa sepse nuk kanë qenë në gjendje t'i llogarisin mirë detyrimet e tyre tatimore. Problemet në implementimin e politikave fiskale kanë edhe një ndikim në ambientin biznesor përmes efektit të evazionit fiskal në tregun (konkurrencën e padrejtë) Kosovar. Oda ekonomike e Kosovës e konsideron evazionin fiskal si gjeneratorin kryesor të konkurrencës së padrejtë në treg. Politikat ekonomike jo të favorshme i konsiderojnë pengesë, rreth 15% e bizneseve të anketuara dhe mungesën e kuadrit të kualifikuar e konsiderojnë pengesë rreth 14% e bizneseve të anketuara. Aftësitë dhe arsimimi i fuqisë punëtore është një determinante kyçe e konkurrimit të bizneseve kosovare në tregun e brendshëm dhe atë të jashtëm. Studimet e mëhershme nga Instituti Riinvest tregojnë se niveli i edukimit të menaxherëve dhe punëtorëve të bizneseve private është relativisht i ulët. Shumica prej tyre kanë shkollimin e mesëm si nivelin më të lartë të edukimit. Këto gjetje janë konfirmuar edhe nga Banka Botërore (2010).

Figura 7. Pasojat që sjellin barrierat e afarizmit për bizneset e anketuara



Burimi: Llogaritjet e autorit

Të gjitha barrierat afariste të diskutuara më sipër kanë efektet e tyre negative në veprimtarinë e bizneseve në Kosovë. Ndikimin më të madh negativ, këto barriera e kanë në produktivitetin e bizneseve. Këtë e kanë deklaruar 32% e bizneseve të anketuara. Sipas tyre barrierat financiare dhe barrierat e tjera afariste ulin produktivitetin e bizneseve, duke kufizuar rritjen dhe zhvillimin e tyre. Këtu barriera gjithashtu reduktojnë fitimet e bizneseve, këtë e kanë deklaruar rreth 25% e bizneseve të marra në studim, pastaj 24% i konsiderojnë këto barriera si shkaktarë për falimentimin e bizneseve dhe pjesa tjetër prej 20% i shohin këto barriera si faktorë që bizneset të humbin reputacionin e tyre. Nga studimi ynë kemi parë se barrierat financiare janë ndër ndikuesit kryesorë për problemet më të cilat ndeshën bizneset. Shumë herë në mungesë të financimeve, bizneset janë të detyruara të mbyllin veprimtarinë e tyre, në pamundësi për të zhvilluar aktivitetet e tyre në mënyrë të vazhdueshme. Më gjithë përmirësimet që janë bërë në uljen e këtyre barrierave, sipërmarrësit i vlerësojnë si negative, në pjesën më të madhe të rasteve. Kosto e këtyre barrierave është bërë e papërbalueshme dhe po shkakton falimentin e bizneseve. Si një mënyrë alternative për përmirësimin e qasjes në financa për NVM-të, është edhe tërheqja e fondeve nga diaspora për investime në Kosovë. Përveç dërgesave të drejtuara drejt subvencionimit të konsumit personal për njerëzit që jetojnë në Kosovë, diaspora është e angazhuar në procesin e privatizimit dhe ka bërë investime direkte në Kosovë. Megjithatë duhet të ketë nxitje financiare shtesë për të inkurajuar investimet e mëtejshme të diasporës dhe partneriteteve të biznesit.

6. Analiza statistikore: Testimi i hipotezës

Hipoteza është një formulim i supozuar rreth një lidhje mes një apo më shumë variablave që do të testohen nëpërmjet analizës empirike (Mc. Daniel & Gates, 1996). Për të realizuar këtë studim jemi nisur nga çështjet kërkimore dhe është ndërtuar hipoteza për t'u testuar dhe që duhet t'i jep përgjigje pyetjeve kërkimore. Meqenëse në këtë studim kemi përdorur metodën e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave, atëherë lidhja që kërkohet të studiojmë do të bazohet në ndikimin e barrierave afariste në rritjen dhe zhvillimin e bizneseve. Si rrjedhim hipoteza që do të shtrohet në këtë studim është:

H1. Në mesin e barrierave afariste, ato financiare kanë rolin më të rëndësishëm në uljen produktivitetit të bizneseve.

H0. Në uljen e produktivitetit të bizneseve, nuk kanë ndikim të rëndësishëm barrierat financiare.

Pasojat e barrierave financiare janë të mëdha në zhvillimin e punës së secilit biznes. Burimet financiare janë burimet kryesore dhe vitale për suksesin e secilit biznes. Barrierat financiare pengojnë punën e bizneseve në mënyra të ndryshme, si: reduktojnë fitimin e këtyre bizneseve, kufizojnë investimet e tyre dhe gjithashtu ndikojnë në uljen e produktivitetit e që pengojnë rritjen dhe zhvillimin e këtyre bizneseve. Një ndikim të tillë e kanë edhe barrierat fiskale dhe ato ekonomike dhe ligjore. Ne përmes analizës së regresionit, do të gjejmë se cila nga këto barrierat ka ndikim më të madhe në produktivitetin e këtyre ndërmarrjeve të marra në studim. Tek kjo analizë ne do përdorim analizën e regresionit të shumëfishtë. Variablat që do të përdoren në këtë analizë janë: barrierat financiare dhe barrierat fiskale si variabla të pavarura dhe produktiviteti si variabël e varur.

Me anë të ekuacionit të regresionit të shumëfishtë mund të shprehim lidhjen që ekziston ndërmjet variablave të varur dhe të pavarur:

$$\hat{Y} = \beta_0 + \beta_1 X_1 + \beta_2 X_2$$

Nga kemi:

\hat{Y} = variabli i varur 'produktiviteti'

X_1 = variabli i pavarur 'barrierat financiare'

X_2 = variabli i pavarur 'barrierat fiskale'

Tabela 1. Përmbledhje e modelit

Model	R	Model Summary		
		R Square	Adjusted R Square	Std. Error of the Estimate
1	.889 ^a	.791	.789	.398

a. Predictors: (Constant), Barrierat_fiskale, Barrierat_financiare

Përmbledhja e modelit na jep të dhënat në lidhje me R, R₂, R₂ e rregulluar, të dhëna në lidhje me devijimin standard të vlerës së vlerësuar. R₂ ose koeficienti i përshtatshmërisë përdoret për matjen e shkallës së përafrimit të lidhjes më anë të ekuacionit të regresionit, d.m.th. shpjegohet variacioni i uljes së produktivitetit nga dy variablat e marra në studim (barrierat financiare dhe barrierat fiskale). Në përgjithësi tabela Model Summary na jep vlerat R për vlerësimin e përshtatshmërisë së përgjithshme të modelit.

CENTRUM 4

Tabela 2. Analiza e regresionit për variablin e varur 'produktiviteti'

Model	Coefficients ^a			t	Sig.
	Unstandardized Coefficients		Standardized Coefficients		
	B	Std. Error	Beta		
1 (Constant)	-.284	.079		-3.579	.000
Barrierat_financiare	.233	.065	.119	3.604	.000
Barrierat_fiskale	1.409	.057	.814	24.749	.000

a. Dependent Variable: Produktiviteti

Nga kjo analizë e regresionit të shumëfishtë rezulton se këto variabla të pavarura shpjegojnë 78.9% të variables së varur 'produktiviteti' ($R^2 = 0.789$). Rezultatet tregojnë së modeli i regresionit është domethënës. Vlera e koeficientit të rregulluar është 0.789 çka tregon se rreth 79% e uljes së produktivitetit varet nga barrierat financiare dhe ato fiskale. Duke përdorur peshat e standardizuara të regresionit, ekuacioni i regresionit të shumëfishtë mund të paraqitet si më poshtë:

$$\begin{aligned}
 \text{'Produktiviteti'} = & -0.284 + 0.233 \text{'Barrierat financiare'} + 1.409 \\
 & \text{'Barrierat fiskale'}
 \end{aligned}$$

Duke marrë për bazë nivelin e signifkancës $p = 0.00$ e që është më e vogël se 0.05, vërtetohet hipoteza e hedhur në shqyrtim, se barrierat financiare kanë ndikim më të lartë në uljen e produktivitetit sesa barrierat e tjera e në këtë rast barrierat fiskale, si variabël e pavarur e marrë në studim. Një gjë e tillë e tregon edhe krahasimi i koeficientëve të këtyre dy variablave të pavarura "barrierat financiare" dhe "barrierat fiskale".

$\alpha = -0.284$ na tregon se marrëdhënia ne mes të variablit të varur dhe variablave të pavarur është negative. Me rritjen e ndonjërit prej variablave të pavarur, p.sh. me rritjen e barrierave financiare, ulet produktiviteti i ndërmarrjeve.

Përfundim

Zhvillimi i bizneseve në Kosovë është i një rëndësie vendimtare për rritjen ekonomike dhe zhvillimin. Të gjitha bizneset, e në veçanti bizneset e vogla dhe të mesme, konsiderohen si gjeneratorë të zhvillimit ekonomik. Mbështetur në të dhënat që studiuam për realizimin e punimit dhe në të dhënat që kemi mbledhur më anë të anketimit, kemi ardhur në këto përfundime:

Struktura e bizneseve të anketuara, sipas hulumtimit tonë na tregon se pjesa më e madhe e bizneseve në Kosovë i takojnë sektorit të

tregtisë, rreth 66% e bizneseve të anketuara. Nga bizneset e anketuara rreth 26% janë deklaruar si biznese shërbyese dhe një pjesë e vogël, vetëm 8% si biznese prodhuese. Nga ky numër i bizneseve të anketuara, me shumë se 90% ishin biznese individuale, sa i përket formës së organizimit të bizneseve. Nga ky numër prej 300 bizneseve, rreth 73% e ushtrojnë veprimtarinë në zonat urbane ndërsa rreth 27% në zonat rurale. Është vërejtur një koncentrim më i madh i sektorit të tregtisë në zonat urbane, si shkak i numrit më të madh të popullsisë në këto zona si dhe koncentrimin më të madh të fuqisë blerëse.

Sa i përket viteve të krijimit, pjesa më e madhe e bizneseve të anketuara, rreth 43% ishin biznese mbi 4 vjet të vjetra. Pastaj një pjesë prej 34% ishin biznese të reja dhe rreth 23% biznese mbi 10 vite. Bizneset mbi 10 vite janë pikërisht ato me një pozicion të rëndësishëm në treg, të cilat i kanë përballuar konkurrencës dhe kanë fituar një pozicion të rëndësishëm.

Sa i përket barrierave që pengojnë rritjen dhe zhvillimin e bizneseve, sipas hulumtimit tonë, dominojnë barrierat financiare me 30%, pastaj informaliteti në ekonomi me 25%, politikat e pafavorshme fiskale me 16%, politikat ekonomike 15% dhe mungesa e kuadrit të kualifikuar me 14%. Të gjitha këto barrierat të përmendura shkaktojnë efekte negative në aktivitetin e këtyre bizneseve dhe pengojnë rritjen dhe zhvillimin e tyre. Hulumtimi tregon se pjesa më e madhe e bizneseve të anketuara, rreth 32% e konsiderojnë si efektin më të madh negativ nga këto barrierat, uljen e produktivitetit, si shkak i presionit nga mjedisi i pafavorshëm afarist. Pjesa prej 25% e bizneseve deklarojnë se këto barrierat reduktojnë fitimet e ndërmarrjeve, 24% deklarojnë se këto barrierat janë shkaktarët për mbylljen e shumë bizneseve dhe pjesa prej 19% i konsiderojnë si faktorë që rrezikojnë reputacionin e bizneseve në përgjithësi.

Përmes hulumtimit tonë dhe përmes studimit të raporteve të ndryshme, mund të themi lirshëm, se ekonomia jonë nuk është duke ofruar kushte të favorshme për krijimin dhe rritjen e bizneseve e veçanërisht për rritjen dhe zhvillimin e NVM-ve. Këto ndërmarrje sot përballën më shumë pengesa dhe një ndër pengesat kryesore konsiderohen të jenë barrierat financiare, si shkak i kostove të larta të financimit. Sistemi financiar në Kosovë nuk është konkurrues dhe nuk ofron shumë zgjidhje për financim. Ndërmarrjeve u duhet të përdorin vetëm kredinë bankare, si burim të jashtëm të financimit, në pamundësi për shfrytëzimin e alternativave të tjera. Institucionet përgjegjëse në Kosovë, duhet

të punojnë më përgjegjësi të plotë dhe të fuqizojnë rritjen ekonomike në nivel makroekonomik, duke bërë reforma në mjedisin biznesor, përmes uljes së informalitetit në ekonomi dhe duke luftuar konkurrencën e pandershme. Përmirësimi i mjedisit biznesor do të rezultonte uljen e riskut të kredive si një ndër faktorët kryesor të interesit në Kosovë. Krijimi i një mjedisi të shëndoshë për zhvillimin e biznesit është shumë i rëndësishëm për të zhvilluar kushtet e NVM-ve. Mjedisi ibiznesit kërkon marrjen e vendimeve nga qeveria për të siguruar barazi në treg, sigurimin e pasurisë dhe zbatimin e kontratave. Pastaj duhet të krijohen lehtësira në treg, në politika fiskale, në politika doganore, në politika tregtare si dhe lehtësira në tregtim dhe ofrimin e kushteve të favorshme ekonomike.

Conclusion

Business Development in Kosovo has a crucial importance for economic growth and development. All businesses, particularly small and medium enterprises, considered generators of economic development. Based on the data studied for the realization of the paper and the data we have collected through the survey, we came to these conclusions:

The structure of the businesses surveyed, according to our research shows the majority of businesses in Kosovo belong to the trade sector, 66% of businesses surveyed. From this number of 300 companies, about 73% exercise their activity in urban areas and 27% in rural areas. It noticed a large concentration of the trade sector in urban areas, due to the greater number of the population in these areas as well as the largest concentration of purchasing barrel.

Regarding the years of creation, most of the businesses surveyed, about 43% were businesses over 4 years old. And some 34% were a new businesses, and 23% were a business over 10 years. Businesses over 10 years are precisely those with an important position in the market, which have faced the competition and have won the important position.

Regarding the barriers that inhibit the growth and development of businesses, according to our research, dominate financial barriers by 30%, then informality in the economy with 25%, unfavorable conditions of tax rates by 16%, economic barriers 15% and lack of staff of unqualified 14%. All these barriers mentioned causing the negative effects on the activity of these businesses and hamper their growth and

development. Research shows that the majority of businesses surveyed, 32% consider the greatest negative impact of these barriers in reduced productivity, due to pressure from unfavorable business environment. The 25% of businesses reported that these barriers reduce the profits of enterprises, 24% declared that these barriers are major causes for the closure of many businesses and the remaining 19% consider that factors are the endanger the reputation of businesses in general.

Through our research and through the study of different reports, we can say freely that our economy is not providing favorable conditions for the creation and growth of businesses veçanërisht for growth and development of SMEs. These enterprises today faced with many obstacles and one of this main obstacles are considered to be financial barriers, due to higher funding costs. Kosovo financial system is not competitive and does not offer many choices for financing. Enterprises are obliged to use bank loans as a source of external financing, unable to use other sources. The responsible institutions in Kosovo must work full responsibility and growth at the macroeconomic level, making reforms in the business environment, through the reduction of the informal economy and combating unfair competition. Improving the business environment will result in the reduction of credit risk as one of the main factors of interest in Kosovo. Creating a healthy environment for business development is very important to develop the conditions of the SMEs. The business environment requires decisions by the government to ensure equality in the market, securing property and enforcing contracts. Then must to create incentives in the market, in fiscal policy, customs policy, trade policy and facilitation in trade and provision of favorable economic conditions.

Literatura

Beck, T. & Demirgüç-Kunt, A., (2006). Small and Medium-Size Enterprises: Access to Finance as a Growth Constraint. *Journal of Banking and Finance* 30, 2931–2943.

Besnik A. Krasniqi” Entrepreneurship and Small Business Development in Kosova, *Nova Science Publisher, New York, 2012.*

BSCKosovo, Entrepreneurship and Business Development in Kosovo (Research Report), Prishtinë, 2011.

Bytyçi, Ilir, Entrepreneurship and Inovative SME'S as a key of Economic Development-Kosovo case, *European Journal of Business Economics and Accountancy*, 2015 (14-21).

Davis, Steven, J., John Haltiwanger, and Scott Schuh. (1993). "Small Business and Job Creation: Dissecting the Myth and Reassessing the Facts." *Business Economics* 29, 13-21.

DR.P.UMA, (2013), Role of SMEs in Economic Development of India, *Asia Pacific Journal of Marketing & Management Review*, (120-126).

European Commission Progress Report on Kosovo 2011 and Riinvest Enterprise Barriers Survey 2011.

Group for legal and Political Studies, 2012, Business environment in Kosovo: A view on the key policy implications.

Hilary, R., (2000). Small and medium sized enterprises and the business environment. Greenleaf Publishing.

Instituti për Hulumtime Zhvillimore RIINVEST (2014), Klima e biznesit në Kosovë, Prishtinë.

Instituti për Hulumtime Zhvillimore RIINVEST (2014), Performanca, Barrierat dhe Besueshmëria e bizneseve në Kosovë, Numeratori Ekonomik 2013, Prishtinë.

Krasniqi, Enver H. & Krasniqi, Sokol, (2013). The Impact of Business barriers in Entrepreneurship and Firm's Growth-Kosovo's perspective, *International Journal of Business and General Management*, (59-56).

Kume, V., Koxhaj, A. & Kume, A. (2009). SMEs - A key factor for economic growth and employment. *Journal of Entrepreneurship and Innovation*, 1:41-49.

Little, Ian M.D. (1987). "Small Manufacturing Enterprises in Developing Countries." *World Bank Economic Review* 1, 203-235.

Louis, D., & Macamo, P., (2011), Barriers to business growth: A study on small enterprises in Maputo, Umea School of Business (Mater thesis).

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (2013), Strategjia për zhvillimin e Sektorit Privat 2013-2017, Prishtinë.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (2011), Strategjia e zhvillimit të NVM-ve në Kosovë 2012-2016, Prishtinë.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (2013), Raporti Vjetor i zhvillimit industrial në Kosovë, Prishtinë, 2014.